



RREGULLORE E QKSS-SË PËR PARANDALIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË NGACMIMIT SEKSUAL

Parandalimi i ngacmimit seksual në vendin e punës është thelbësor për të arritur barazinë gjinore dhe për të krijuar një mjedis ku sigurohet harmonia dhe siguria në ambientin e punës. Kjo përfshin respektimin e të drejtave të njeriut, zbatimin e ligjit të punës, ligjin për barazinë gjinore dhe konventat ndërkombëtare relevante.

Ngacmimi seksual paraqet një shkelje penale. Sipas Nenit 183, Paragrafi 2 i Kodit Penal, ngacmimi seksual përfshin çdo formë të sjelljes verbale, joverbale ose fizike të natyrës seksuale, e cila është e padëshiruar dhe ka si qëllim cenimin e dinjitetit të personit, duke krijuar një mjedis që është objektivisht frikësues, armiqësor, degradues ose poshtërues.

Rregullorja e QKSS, për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të ngacmimeve seksuale është një komponent i rëndësishëm i strukturës së rregulloreve të punës dhe politikave të brendshme të organizatës. Kjo rregullore ka për qëllim të krijojë një mekanizëm të strukturuar dhe efikas për trajtimin e ankesave për ngacmim seksual.

Përmes kësaj rregulloreje, QKSS angazhohet në forcimin e standardeve dhe praktikave të qarta që ndihmojnë në parandalimin e ngacmimeve seksuale dhe menaxhimin e tyre në vendin e punës. Kjo përfshin ndërgjegjësimin e punonjësve/eve, trajnimin për identifikimin e sjelljeve të padëshiruara, procedurat e ankesave dhe hetimeve të rasteve, si dhe masat disiplinore për ata që shkelin këto rregulla.

Rregullorja hyn në fuqi: 01 Shtator 2023

Mentor Vrajolli,


Drejtor Ekzekutiv

TË GJITHË PUNONJËSIT/ET E QKSS-SË KANË OBLIGIM DHE PËRGJEGJËSI PËR TË VEPRUAR NË PËRPUTHJE ME KËTË RREGULLORE.

I. QËLLIMI I RREGULLORËS

1. *Informimi i të gjithë punonjësve/eve se ngacmimi seksual nuk do të tolerohet dhe se ata që kryejnë ngacmime do të mbajnë përgjegjësi;*
2. *Krijimi i mekanizmave brenda organizatës për të mundësuar raportimin dhe shqyrtimin e ngacmimeve seksuale;*

II. FUSHËVEPRIMI

1. *Kjo rregullore zbatohet në të gjitha kategoritë e punonjësve/eve të organizatës – midis mbikëqyrësve/eve, anëtarëve/eve të stafit, bashkëpunëtorëve/eve dhe të tjerëve.*

III. DEFINIMI I VENDIT TË PUNËS

1. *Të gjitha zyrat, si dhe hapësirat ose mjediset jashtë zyrave të organizatës, ku realizohen puna dhe aktivitetet e saj;*

IV. DEFINICIONI I NGACMIMIT SEKSUAL

Ngacmimi seksual përkufizohet si çdo sjellje e natyrës që cenon dinjitetin e të gjitha gjinive, dhe konsiderohet e padëshiruar, e papranueshme, e papërshtatshme dhe fyese, duke shkaktuar një mjedis pune të frikshëm dhe armiqësor. Ngacmimi seksual përfshin çdo lloj sjelljeje të padëshiruar verbale, joverbale apo fizike me natyrë seksuale, e cila ka për qëllim ose ndikon në cenimin e dinjitetit të një personi, veçanërisht duke krijuar një atmosferë kërcënuese, poshtëruese apo denigruese.



Ngacmimet seksuale përfshijnë sjelljet fizike ose kontaktin fizik, duke përfshirë këto shembuj:

1. *a) Çdo kontakt fizik i padëshiruar dhe i drejtpërdrejtë duke filluar nga prekja, përçafimi, puthja, përkëdhelje;*
b) Sulmet, pengimi apo bllokimi i lëvizjeve ose kontakti i drejtpërdrejtë fizik;

Ngacmimet seksuale përfshijnë format verbale, duke përfshirë këto shembuj:

2. *a) Kërcënime me kushtëzim të vendit të punës ose ofrimi i beneficioneve në punë;*
b) Përdorimi i emrave abuzivë, ofendimeve, komente denigruese me konotacione seksuale për një person ose një grup të caktuar;
c) Komentet me konotacione seksuale në lidhje me veshjet, pamjen etj.

Ngacmimet seksuale përfshijnë format joverbale, duke përfshirë këto shembuj:

3. *a) Shikime të dyshimta, bërja e gjesteve dhe tregimi i fotografive poshtëruese dhe me konotacione seksuale;*
b) Shfaqja e padëshiruar e materialeve - fotografive dhe objekteve me ngjyrim seksuale;
c) Dërgim i mesazheve denigruese me përmbajtje seksuale përmes e-mailit, teksteve dhe postimeve në rrjete sociale ose kanale të tjera të komunikimit.

V. VEPRIMET DHE MASAT DISIPLINORE

1. *Në rast se një punonjës/e përballet me ndonjë formë të ngacimit seksual, ai/ajo duhet të njoftojë dhe të raportojë menjëherë rastin te Komisioni për Trajtimin e Rasteve të Ngacimit Seksual (Komisioni);*


2. *Me qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje, QKSS ka themeluar një komision për trajtimin e rasteve të ngacimit seksual, me qëllim për t'u siguruar një trajtim efikas për të gjitha ankesat në lidhje me ngacmimet seksuale;*

VI. PËRBËRJA E KOMISIONIT

1. *Komisioni përbëhet nga tre anëtarë/e;*
2. *Antarët e Komisionit zgjidhen nga Kuvendi i Anëtarëve të Organizatës;*
3. *Komisioni përbëhet nga një anëtar/e e Bordit Drejtues dhe dy punonjës të organizatës që nuk janë të përfshirë në rastin e raportuar;*

VIII. PROCEDURAT E RAPORTIMIT NË KOMISION

1. *Çdo punonjës/se i/e prekur nga ngacmimi seksual, mund të paraqesë ankesë me shkrim në Komision, brenda një periudhe prej tre muajsh pas shfaqjes së incidentit;*
2. *Çdo punonjës/e mund të paraqesë ankesë me shkrim në Komision, për shqetësim të dyshuar për hakmarrje nga punëdhënësi për raportimin e ngacimit seksual në vendin e punës;*
3. *Ankesa për raportimin e ngacimeve seksuale duhet të dorëzohet në formën elektronike, duke përdorur adresën e emailit të përcaktuar nga organizata – report@qkss.org ;*
4. *Qasja në adresën e emailit për raportimin e ngacimeve seksuale mund të bëhet vetëm nga anëtarët e Komisionit të zgjedhur nga Kuvendi i Anëtarëve të Organizatës.*
5. *Hetimi i rastit nga Komisioni për rastet e ngacimit seksual duhet të përfundojë brenda një periudhe prej 7 deri më 14 ditë.*



IX. KOMPETENCAT E KOMISIONIT JANË:

1. *Hetimin e çdo ankese për ngacmim seksual;*
2. *Thirrjen e dëshmitarëve (sipas nevojës) për të kërkuar dëshmi për hetimin e rastit;*
3. *Çdo punonjës/se ka për detyrë të bashkëpunojë me Komisionin gjatë procesit të hetimit. Refuzimi për të bërë këtë mund të rezultojë në masa disiplinore.*
4. *Marrja e masave disiplinore në lidhje me incidencën për ngacmim seksual;*
5. *Komisioni ka të drejtë të vazhdojë hetimin për pretendimin për hakmarrje kundër punonjësit/et që ka raportuar për ngacmimin seksual ose që merr pjesë në një hetim.*
6. *Çdo individ që përfshihet në sjellje hakmarrëse do të ju nënshtrohet masave disiplinore, të cilat mund të përfshijnë përfundimin e punësimit.*

X. MASAT DISIPLINORE

1. *Në rast se Komisioni konstaton se ka prova se punonjësi/sa është përfshirë në ngacmimin seksual, siç është përcaktuar në këtë rregullore, atëherë ai/ajo do të ju nënshtrohet masave disiplinore. Komisioni do të njoftojë me shkrim punonjësin/en që ka paraqitur ankesën dhe punonjësin/en e akuzuar duke i informuar ata/ato për rezultatin e hetimit.*
2. **Nëse ndonjë punonjës/se është konstatuar që është fajtor/e për ngacmim seksual, masat disiplinore që mund të ndërmerren janë këto:**
 - a) *Vërejtje me shkrim;*
 - b) *Suspendim pa kompensim;*
 - c) *Largim nga puna;*
 - d) *Raportimi i rastit në institucionet përkatëse.*



XI. KONFIDENCIALITETI

1. *Komisioni dhe QKSS njeh dhe respekton të drejtën e një punonjësi/eje për privatësi dhe nevojën për konfidencialitet.*

2. *Komisioni do të ruajë konfidencialitetin dhe identitetin të një punonjësi/e në lidhje me ngacmimet seksuale (në masën e lejuar me ligjin), përveç rastit kur kjo mund të çojë në dëmtim fizik të ndonjë personi dhe/ose mund të rrezikojë sigurinë brenda vendit të punës.*

3. *Komisioni do të ndajë informacionin e dhënë vetëm për të garantuar sigurinë e punonjësit/es që ka raportuar ngacmimin seksual. Në këtë rast, Komisioni duhet të njoftojë paraprakisht punonjësin/en që ka raportuar ngacmimin seksual për ndarjen e informacionit dhe arsyen për të ndarë këtë informacion.*

XII. HYRJA NË FUQI

1. *Kjo rregullore hyn në fuqi me datën 1 shtator 2023.*

Rregullorja hyn në fuqi: 01 Shtator 2023

Mentor Vrajolli,


Drejtor Ekzekutiv